



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1389_10_15**;
- Ankesa e KESCO-s e datës **23.10.2015**;

në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHE** ankesa e KESCO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Hysni Blakqori me shifër DPR - 400995 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1389_10_15** i datës 01.10.2015.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 23.10.2015 ka pranuar ankesë nga KESCO kundër vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve për konsumatorin Hysni Blakqori me te cilën ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të pezulloj vendimin e DMK-së dhe marr vendim për anulimin e këtij korigjimi ndërsa vlera e për korigjim të mbetet kontest deri në përfundimin e procedurave ligjore. KESCO në ankesën e saj ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka atakuar disa çështje. Në ankesë theksohet se vendimi i DMK-së me largimin e urave kemi keqpërdorim apo shpenzim të paautorizuar dhe duhet të ketë shpenzim shtesë pasi që kemi të bëjmë me humbje të shpenzimit. KESCO në ankesë ka theksuar se kur njehsori elektrik është i vulosur me vulë distributive dhe se në brendi të saj ka ura të larguara atëherë kjo duhet të trajtohet si keqpërdorim i energjisë elektrike dhe ngarkohen me kWh shtesë pasi që mendohet se konsumatori është në dijeni për largimin e urave dhe se për këto raste lënda kalon në gjykatë. KESCO në ankesë ka theksuar se konsumatori sipas rrjedhës së energjisë mujore ka faturim jo proporcional në muaj, sezona dhe vite të caktuara dhe se rrjedha nuk duhet të merret parasysh në këtë rast. KESCO në vazhdim të ankesës ka theksuar se inspektimi i urës është bërë në periudhën 12/2013 dhe se gjatë analizës së bërë muajve 09/2013, 10/2013, 11/2013 para kontestit shpenzimi ka qenë 518 kWh ndërsa pas faturës kontestuese 12/2013, 01/2014 dhe 02/2014 shpenzimi ka qenë 917 kWh që do të thote se ka rritje për 77%. Në fund KESCO ka theksuar se nuk duhet të merret parasysh shpenzimi tre muaj para dhe pas periudhës kontestuese pasi që konsumatori mundet të kontrolloj shpenzimin.

Me datë 11.12.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikës matëse kanë dal te konsumatori dhe kanë konstatuar se në momentin e kontrollës së njehsorit elektrik është hequr



blloba distributive për të bërë kontrollën e njehsorit elektrik dhe nga kjo është konstatuar se faza e dytë është e zhvendosur dhe nuk bënë matjen e energjisë elektrike, gjithashtu në proces është konstatuar se pas inspektimit njehsori është ribllombuar prapë në këtë gjendje dhe është kyçur në rrjetin elektrik.

Me datë 16.01.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikës matëse kanë dal te konsumatori dhe kanë konstatuar se në bazë të procesverbalit me numër 0792512 kemi hasur te konsumatori i cili ishte i bllobuar, por kishte urën e dytë të larguar dhe nuk bënte matjen e energjisë së shpenzuar.

Nga transaksionet e konsumatorit shihet se KEDS me datë 08.10.2014 me anë të faturës me numër 67920 të datës 08.10.2014 ka ngarkuar konsumatorin me borxh në vlerë financiare prej 116.19€ për faturim plotësues për shkak të mos matjes së shpenzimit të energjisë në urën e dytë të njehsorit elektrik.

Konsumatori me datë 23.12.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS, me të cilën ka kundërshtuar faturimin e KEDS në vlerë financiare prej 116.19€, me arsyetimin se nuk e din arsyen e kësaj vlere të ngarkuar.

Në bazë të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 24.12.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij, me arsyetimin se KEDS ka bërë faturim plotësues me vlerën financiare prej 116.19€ duke u bazuar në procesverbalin me nr. 0792512 i datës 11.12.2013 si dhe procesverbalin me nr. 0847072 i datës 16.01.2014 si dhe kërkesën nga sektori i faturimit të datës 29.09.2014.

I pakënaqur me përgjigjen e lëshuar nga ana e KEDS, konsumatori me datë 24.12.2014 ka parashtruar ankesë në DMK/ZRRE. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 13.01.2015 ka nxjerrë vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KESCO që të shkarkojë shifrën e konsumatorit DPR - 400995 nga ngarkesa/korrigjimi nr. 67920DPR-400995-400995 i datës 08.10.2014 i ngarkuar si faturim plotësues në vlerë financiare prej 116.19€.

KESCO në ankesën e saj ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka atakuar disa çështje. Në ankesë theksohet se vendimi i DMK-së me largimin e urave kemi keqpërdorim apo shpenzim të paautorizuar dhe duhet të ketë shpenzim shtesë pasi që kemi të bëjmë me humbje të shpenzimit. KESCO në ankesë ka theksuar se kur njehsori elektrik është i vulosur me vulë distributive dhe se në brendi të saj ka ura të larguara atëherë kjo duhet të trajtohet si keqpërdorim i energjisë elektrike dhe ngarkohen me kWh shtesë pasi që mendohet se konsumatori është në dijeni për largimin e urave dhe se për këto raste lënda kalon në gjykatë. KESCO në ankesë ka theksuar se konsumatori sipas rrjedhës së energjisë mujore ka faturim jo proporcional në muaj, sezona dhe vite të caktuara dhe se rrjedha nuk duhet të merret parasysh në këtë rast. KESCO në vazhdim të ankesës ka theksuar se inspektimi i urës është bërë në periudhën 12/2013 dhe se gjatë analizës së bërë muajve 09/2013, 10/2013, 11/2013 para kontestit shpenzimi ka qenë 518 kWh ndërsa pas faturës kontestuese 12/2013, 01/2014 dhe 02/2014 shpenzimi ka qenë 917 kWh që do të thote se ka rritje për 77%. Në fund KESCO ka theksuar se nuk duhet të merret parasysh shpenzimi tre muaj para dhe pas periudhës kontestuese pasi që konsumatori mundet të kontrolloj shpenzimin.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KESCO-s nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj.

Sa i përket kundërshtimit të parë dhe të dytë nga ana e KESCO-së se DMK ka rënë në kundërshtim me veten e saj duke theksuar se si është e mundur që një urë të jetë larguar dhe të mos trajtohet si



keqpërdrim pasi aty kemi humbje të energjisë elektrike, si dhe se në raste të tilla kur njehsori është i vulosur dhe urat janë të larguara mendohet se konsumatori ka qenë në dijeni dhe këto lëndë kalojnë gjykatë, Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të lëndës së konsumatorit dhe ankesës së KESCO konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë. Bordi i ZRRE-së thekson se me këto dy pikë të kundërshtimit është vet KESCO që është në kontradikt mes ankesës së parshtruar dhe veprimeve të tyre. Bordi i ZRRE-së konstaton se KESCO këtë lëndë nuk e ka trajtuar si shfrytëzim të paautorizuar (rikthim i humbjeve), por e ka trajtuar si faturim plotësues. Bordi i ZRRE-së thekson se në rast se kjo ankesë do të ishte trajtuar si shfrytëzim i paautorizuar, ZRRE nuk do të shqyrtonte këtë ankesë pasi nuk ka kompetenca për shqyrtim të kësaj kategorie dhe atë bazuar në nenin 39 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe nenin 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, por kompetente është gjykata.

Sa i përket kundërshtimit tjetër se nuk duhet të merret për bazë mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike pasi ka fautim jo proporcional dhe se këtu kemi të bëjmë me keqpërdorim. Bordi i ZRRE-së thekson se pas analizimit të gjitha këtyre të dhënave konstaton se në këtë pikë matëse nuk është vërtetuar ndonjë element se është shkaktuar humbje e shpenzimit të energjisë elektrike përmes largimit të një ure, ashtu siç theksohet në procesverbalet e KEDS-it, se për një të tretën e energjisë njehsori elektrik nuk ka regjistruar energjinë elektrike, për faktin se mos regjistrimi i energjisë elektrike përmes largimi/zhvendosjes së një ure pas rregullimit të saj do të duhej të ndikonte në rritjen e shpenzimit të energjisë elektrike dukshëm (për një të tretën e energjisë elektrike) në raport me regjistrimin paraprak të energjisë elektrike për shkak të ngarkesave (shtesë) që i bëhen në atë lidhje. Por në rastin konkret nga analizat e bëra shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë me asnjë element nuk vërtetohet keqpërdorimi i mundshëm i energjisë elektrike të shkaktuar në këtë pikë matëse.

Kundërshtimi tjetër i KESCO-së është se pas aktivizimit të urës së dytë përmes procesverbalit të periudhës 12/2013 shpenzimi i energjisë elektrike konsumatorit i është rritur. Bordi i ZRRE-së ka analizuar shpenzimet e energjisë elektrike për periudhën për të cilën KEDS-i ka bërë ngarkimin shtesë të konsumatorit me një të tretën e energjisë (1/3) prej 08/2013 e deri më 01/2014, rezulton se mesatarja mujore e shpenzimit gjatë kësaj periudhe është 702.17 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë kohore por mbas një viti 08/2014 e deri më 01/2015 është 597.00 kWh/muaj. Po ashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e gjithëmbërshëm para dhe pas periudhës kontestuese dhe gjatë analizës ka rezultuar se nuk ka rritje të shpenzimit të energjisë elektrike në periudhën pas periudhës kontestuese në krahasim me periudhën para periudhës kontestuese.

Lidhur me pikën tjetër të kundërshtimit me aktivizimin e urës së dytë në periudhën 12/2013, Bordi i ZRRE ka analizuar edhe procesverbalet e KEDS në të cilët është konstatuar gjendja e njehsorit elektrik nr. 21030321 në pikën matëse të konsumatorit. Vlen të theksohet se në procesverbalin me nr. 0792512 të datës 11.12.2013 është konstatuar se njehsori elektrik ka bllobën distributive, por që urën e mesme (2) e ka të zhvendosur dhe nuk bënë matjen e energjisë elektrike dhe sipas këtij procesverbali e njëjta gjendje është mbetur nga këta zyrtar pa marr asnjë veprim konkret edhe përkundër asaj që kanë qenë të obliguar të rregullojnë pikën matëse në rastet e defekteve të mundshme. Kjo gjendje ka vazhduar të mbetet për më tepër se një muaj, pasi që edhe në procesverbalin e kontrollës së KEDS-it nr.0847072 të datës 16.01.2014 është konstatuar se njehsori elektrik është i bllobubar, por ka urën e dytë të larguar dhe nuk bënë matjen e energjisë së shpenzuar. Për këtë Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS-i ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1338_06_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të



të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së
- Konsumatorit Hysni Blakqori, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.